

647

DT 13.02.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 2141 prot.

Elbasan, më 09.2.2024

Lënda: Mbi ligjshmërinë e aktit

KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr. 107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", përpara se të shprehemi në lidhje me ligjshmërinë e aktit tuaj Nr. 11 datë 30.01.2024 "Për hapje rruge për kalim mjetesh bujqësore", kërkojmë:

1 - Kopjet e njehsuara me origjinalin të deklaratave të dakortësisë të noterizuara të pronarëve privatë pronat e çertifikuara të të cilëve ndodhen (janë kufitarë) mbi e nën pasurinë me Nr. 336 me pronar shtetin, e llojit mezhdë mbi të cilën kërkohet të hapet rruga ku ata të shprehen se janë dakort për hapjen e rrugës në mezhdë.

2 - A ka projekt të hartuar nga drejtoria përkatëse përgjegjëse e Bashkisë Librazhd për hapjen e kësaj rruge? Nëse ka, të na vihet në dispozicion një kopje e tij ku midis të tjerave në të të jenë të specifikuara gjatësia, gjerësia e rrugës, profilet tërthorë të saj, numri i familjeve fermere që përfitojnë nga hapja e rrugës si dhe impakti që i sjell komunitetit të zonës hapja e saj.

3- Për mbulimin e shpenzimeve që do të bëhen për hapjen e rrugës (element përbërës tjetër ky i projektit), kush do të jetë investitori i saj (Bashkia Librazhd apo shtetasi i interesuar – objekt i aktit tuaj)?

Sa është vlera në para e këtij investimi? Të sillet kopja e preventivit me të gjithë zërat e punimeve të hartuar për këtë qëllim.

4 - Kopjen e kërkesës së z.Nazmi Roçi paraqitur në Bashkinë Librazhd për hapjen e rrugës – objekt i aktit tuaj.

5 – Kopjen e propozimit të bërë nga Kryetari Bashkisë Librazhd për hapjen e kësaj rruge.

6– Kopjen e Çertifikatës së Vërtetimit të Pronësisë të shoqëruar me HTR-n si dhe me Kartelën e Pasurisë të z.Nazmi Roçi për të cilën shtetasi në fjalë ka kërkuar hapjen e kësaj rruge për të bërë të mundur lidhjen e rrugës së fshatit me parcelën e tij (për të parë se ku ndodhet në hartë kjo pasuri dhe me çfarë numri është e identifikuar ajo).

Deri në dërgimin e këtyre të dhënave, akti juaj mbetet i pa konfirmuar.

PREFEKTI



Majlinda PERRIU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZH
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Datë.01.02.2024

Nr. 642 prot
/10

Nr.11 dt.30.01.2024

PËR HAPJE RRUGE PËR KALIM MJETESH BUJQËSORE

Mbështetur në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015“Per veteqeverisjen Vendore” Neni 54
“Për detyrat dhe kopetencat e Këshillit Bashkiak” Këshilli Bashkiak i mbledhur sot më datë
30.01.2024 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd:

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës për hapje rruge për kalim mjetesh bujqësore për kalim nga rruga e fshatit deri te parcela e z.Nazmi Roçit,lagjia Roçit,fshati Hotolisht,Njësia Administrative Hotolisht.
2. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Punëve Publike.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

SEKRETAR I KËSHILLIT
Elson MALLUTA

KRYETARI I KËSHILLIT
Mitat BIÇAKU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHË
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

RELACION

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Nenit 54 “Për detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak”, kërkohet hapje rruge për kalim mjetesh bujqësore për në tokën e z. Nazmi Roçi në fshatin Hotolisht .
Kjo tokë është në pronësi të Nazmi Roçi i cili ka paraqitur kërkesa në bashki disa në lidhje me këtë fakt.
Toka që pronari disponon është përfituar me AMTP sipas ligjit nr.7501 “Për tokën” .
Rruga që do të hapet do të kalojë në pasurinë nr.336 e llojit mezhde .
Me qëllim të zgjidhjes ligjore të këtij problemi i paraqesim këtij këshilli këtë projekt vendim .
Bashkëngjitur këtij relacioni fragment të hartës për pasurinë nr.336.

Sekretari i përgjithshëm

~~Bajram Pishkashi~~

